



## **INSTITUTI “HARRY FULTZ”**

Rr: “Asim Vokshi”, Tirane

Tel: +355 4 22 87 46

Cel: +355 68 20 60 128

[www.harryfultz.edu.al](http://www.harryfultz.edu.al)

[info@harryfultz.edu.al](mailto:info@harryfultz.edu.al)

### **Të nderuar prindër dhe të dashur nxënës të Institutit “Harry Fultz”!**

Me shpërndarjen e shpejtë të virusit Covid-19 në më shumë se 100 vende, Organizata Botërore e Shëndetësisë “OBSH”-ja e ka klasifikuar atë një pandemi globale. Shumë vende kanë marrë dhe janë duke marrë masa për të luftuar përhapjen e këtij virusi, ku masat kryesore janë distancimi social, mbyllja dhe kufizimi i të gjitha aktiviteteve që nuk janë jetike ose thelbësore.

Me zbulimin e rastit të parë me Covid-19 në vend, edhe qeveria e Republikës së Shqipërisë i është bashkuar vendeve që kanë marrë këto masa. Një nga masat e marra është edhe vendimi për mbylljen e veprimtarisë arsimore në Republikën e Shqipërisë, sipas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 190, dt. 19.03.2020: *Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore Publike dhe Jo-Publike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19.*

Instituti “Harry Fultz”, ju njofton se në zbatim të këtij urdhri, Shkolla e mesme “Harry Fultz” si dhe Kolegji Komunitar do të jenë të mbyllura deri në datën 03.04.2020. Instituti Harry Fultz është në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe do të njoftojë në kohë lidhur me urdhrat dhe vendimet e marra lidhur me rifillimin e procesit arsimor.

Gjatë kësaj periudhe, Instituti “Harry Fultz” ka marrë të gjitha masat që procesi mësimor të vazhdojë me klasa virtuale duke përdorur platformat e mësimdhënies online. Të gjitha klasat e shkollës së mesme po funksionojnë online, duke përdorur platformën Google classroom, ku nxënësit marrin mësimet e reja, komunikojnë me mësuesin e lëndës përkatëse si dhe vlerësohen me notë. Gjithashtu një pjesë e këtyre mësimëve në distancë, mund të gjenden të publikuara edhe në faqen zyrtare të Institutit “Harry Fultz” ne facebook.

Deri në një njoftim tjetër zyrtar...

**Instituti “Harry Fultz”**